



07 gusht 2024

## KOMUNIKATË

### Seanca e nëntë (IX) e Bordit të ZRRE në 2024

Sot, më 07 gusht 2024, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur seancën e nëntë me radhë për këtë vit.

Në këtë seancë, Bordi i ZRRE-së shqyrtoi dhe mori vendime mbi:

1. Miratimin e Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar - me miratimin e kësaj procedure përcaktohet metodologjia e vlerës së garancionit financiarë para se një palë tregtare të mund të dorëzojë nominimet kontraktuale, nominimet fizike, ofertat për shitje dhe ofertat për blerje sipas rregullave të tregut.
2. Miratimin e Procedurës së Rregullave të Tregut për Nominimet - me miratimin e kësaj procedure përcaktohen përgjegjësitë e palëve tregtare për të dorëzuar nominimet fizike ,nominimet kontraktuale, nominimet ndërkufitare, përgjegjësit e bursave të energjisë për të dorëzuar nominimet kontraktuale tek OT, metodat dhe efektet e dorëzimit.
3. Miratimin e rivlerësimit të sasisë së kapaciteteve ndërkufitare Shqipëri- Kosovë për procesin e bashkimit të tregjeve.
4. Miratimin e dhënies së autorizimit për dy projekte për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë me erë me kapacitet total prej 70MW Projekti Energjetik-Wind Park Zatriq 1 & 2.
5. Miratimin e dhënies së autorizimit për 82 kërkesa për ndërtimin të paneleve solare për konsumatorët vetë- prodhues (prosumatorë) me gjithsej 1,584 kW.

Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qenë ankesat e konsumatorëve si dhe disa çështje të tjera që ndërlidhen me funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Të gjitha vendimet e Bordit të ZRRE do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të ZRRE [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org), web: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)